

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

THIRRJE PËR TENDER

Prishtinë, 27 janar 2026

Për përzgjedhjen e kompanisë implementuese

Projekt: “Identifikimi i Hershëm i Talenteve të Rinj në Sport”

Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) shpall thirrje të hapur për përzgjedhjen e një kompanie implementuese për realizimin e projektit strategjik “Identifikimi i hershëm i talenteve të rinj në sport”, një iniciativë kombëtare që synon ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të digjitalizuar për zbulimin, orientimin dhe zhvillimin e fëmijëve drejt sporteve më të përshtatshme dhe me potencial elitare.

Sporti modern kërkon që aftësitë fizike dhe motorike të fëmijëve të identifikohen sa më herët, në mënyrë objektive dhe profesionale. Në mungesë të një sistemi të strukturuar të vlerësimit fizik në moshë të hershme, shumë potenciale sportive mbeten të pazbuluara, ndërsa fëmijët shpesh orientohen drejt aktiviteteve që nuk përputhen me profilin e tyre trupor dhe motorik.

Ky projekt synon ta adresojë këtë boshllëk përmes vendosjes së një procesi të standardizuar të matjeve antropometrike në shkollat fillore, duke krijuar një bazë të besueshme dhe shkencore për vlerësimin e zhvillimit fizik të fëmijëve dhe identifikimin e potencialit të tyre sportiv.

1. Qëllimi i projektit

Qëllimi i këtij projekti është të zbatohet një proces të strukturuar të matjeve antropometrike dhe vlerësimit fizik të fëmijëve në shkollat fillore, me synim identifikimin e hershëm të potencialit sportiv, aftësive motorike dhe karakteristikave fizike që lidhen me sporte të ndryshme.

Nëpërmjet këtij procesi, projekti synon të mundësojë zbulimin dhe orientimin e talenteve në moshë të hershme, si dhe të mbështesë zhvillimin e shëndetshëm dhe aktiv të fëmijëve. Të dhënat e mbledhura përdoren për analizë profesionale dhe monitorim, si mjet mbështetës për realizimin e këtij qëllimi.

Ky sistem do të shërbejë si themeli i politikave afatgjata të zhvillimit të sportit dhe talenteve në Kosovë.

2. Qëllimi i angazhimit

KOK synon të përzgjedhë një kompani implementuese që do të jetë përgjegjëse për:

- Zhvillimin e matjeve
- Projektimin dhe zhvillimin e platformës digjitale;
- Implementimin e sistemit në nivel kombëtar;
- Sigurimin e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të mëtejshme teknik;

Kompania e përzgjedhur do të veprojë në partneritet të ngushtë me KOK për aspektet metodologjike dhe përmbajtësore të projektit.

3. Kriteret e përgjithshme të kualifikimit

Kompania aplikuese duhet:

- Të jetë e regjistruar ligjërisht dhe aktive për së paku 5 vite në Kosovë;
- Të ketë përvojë të dokumentuar në:
 - Zhvillimin e platformave digjitale në shkallë kombëtare ose ndërkombëtare;
 - Projekte në fushën e sportit, edukimit ose shëndetit publik;
- Të disponojë ekip minimal profesional që përfshin:
 - 1 menaxher projekti;
 - 2 zhvillues softueri (.NET, React, SQL Server);
 - 1 dizajner UI/UX;
 - 1 specialist të sigurisë së të dhënave;
 - 1 ekspert të sportit ose edukatës fizike;
 - 1 ekspert të hulumtimeve dhe të dhënave;
- Të ofrojë plan mirëmbajtjeje për minimum 5 vite pas përfundimit të zhvillimit.

Përvojë në menaxhim dhe mbledhje të të dhënave

Kompania duhet të ketë përvojë të dokumentuar në mbledhjen, menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave në kuadër të projekteve të mëdha kombëtare ose ndërkombëtare, veçanërisht në fushat e sportit, shëndetit publik, edukimit ose hulumtimeve sociale.

Kjo përvojë duhet të dëshmohet përmes referencave, kontratave ose raporteve të projekteve të mëparshme dhe do të vlerësohet si pjesë e ofertës teknike.

4. Fusha e punës dhe rezultatet e pritura

Kompania e përzgjedhur do të jetë përgjegjëse për:

- Bashkë-hartimin e sistemit të matjes së aftësive sportive me ekspertët e KOK;
- Zhvillimin e platformës me modulet:
 - Moduli për KOK
 - Moduli për arsimtarë dhe trajnerë
 - Moduli për klube dhe federata
 - Moduli për evente sportive
 - Moduli për testime dhe matje periodike të nxënësve
- Integrimin e të dhënave antropometrike, fizike dhe performuese në databazë të sigurt;
- Trajnimin e përdoruesve (manuale, video, helpdesk);
- Sigurimin e përputhshmërisë me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Raportim periodik te bordi ndërinstitucional.

5. Kohëzgjatja dhe afatet

- Kohëzgjatja totale e projektit: 12 muaj
- Platforma duhet të jetë funksionale brenda 6 muajve
- Faza: pilot → shtrirje kombëtare → mirëmbajtje → zhvillim

6. Dokumentacioni i kërkuar

Aplikantët duhet të dorëzojnë:

1. Certifikatë regjistrimi
2. CV të ekipit
3. Portofol projektesh
4. Metodologji dhe plan pune, përfshirë metodologjinë e matjes dhe vlerësimit të fëmijëve (antropometrik, fizik, motorik dhe funksional) dhe mënyrën e interpretimit të të dhënave për orientim sportiv
5. Propozim buxheti i detajuar
6. Plan mirëmbajtjeje 5-vjeçare

7. Kriteret e vlerësimit

Ofertat do të vlerësohen në bazë të parimit të ofertës ekonomike më të favorshme, sipas peshës:

- **Propozimi Teknik: 80%**

(përfshin metodologjinë, zgjidhjen teknike, ekipin, sigurinë e të dhënave, planin e implementimit dhe qëndrueshmërinë)

- **Propozimi Financiar: 20%**

(përfshin realizueshmërinë dhe efikasitetin e kostos)

Vetëm ofertat që kalojnë fazën administrative dhe teknike do të vlerësohen financiarisht.

8. Dorëzimi i aplikimeve

Aplikimet duhet të dorëzohen në format PDF në adresën:

office@noc-kosovo.org

Afati i fundit: 04 shkurt 2026, ora 16:00

Subjekti i emailit:

“Tender – Identifikimi i hershëm i talenteve – [Emri i kompanisë]”

Për çdo informacion shtesë në lidhje me këtë thirrje, aplikantët mund të kontaktojnë në:
office@noc-kosovo.org